




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Tribuna Media Group” Sh.p.k.
Numri i biznesit - 71110257
Pronare – Besiana HOTI
OSHMA TRIBUNA CHANNEL
Rr/ Mark Isaku Nr.4
Prishtinë

Ref:1911/1376/LIC/ni

VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes Tribuna Channel, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Tribuna Channel është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 15 qershor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA Tribuna Channel.
3. Me datën 15 qershor 2019, ka skaduar afati i licencës për Tribuna Channel, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 21 janar 2019, Tribuna Channel ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

5. OSHMA Tribuna Channel, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedurat e përcaktuara administrative nga KPM.

6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkëljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

Vendim

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 12 dhjetor 2019, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së TRIBUNA CHANNEL, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
8. Licenca e KPM-së për OSHMA Tribuna Channel do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 15 qershor 2019.
9. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA Tribuna Channel, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



18.12.2019.

datë